Nr. 4886/1 Prot
Dt. 16.07.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 503/1 Prot.

Shkodër, më 14.07.2026

**Lënda:** Mbi vendimet nr.40, nr. 42 dhe nr. 43 datë 29.06.2026 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 4; ligji nr.38/2019, ligji 8743 date 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligji nr.8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësistë e qeverisjes vendore", i ndryshuar , në VKM nr.246 dt. 31.03.2011 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.68 dt.28.01.2008, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të qarkut Shkodër" në VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shteterore", të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 13, date 18.04.2018 "Për zbatim të VKM nr. 54, datë 5.02.2014", në Vkm nr.672 datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime në VKM-në nr.54 datë 05.02.2024 "Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, të ndryshuar ne VKM-në nr.701 datë 13.11.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime më VKM-në nr.54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve…….(sipërcituar)", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 4578 prot., datë 23.06.2026 "Shkresë përcjellëse", shqyrtoi VKB nr. 40 datë 29.06.2026 *"Për dhënie në përdorim të sipërfaqes prej 0.3428 ha për agroturizëm"; VKB nr. 42, datë 29.06.2026 "Për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr.92, ZK nr.2644 e llojit "shkëmbore" (pa fryt), fshati Melgushë, NJAD Bushat, bashkia Vau Dejës, fusha e përdorimit të pronës, për veprimtari në fushën e blegtorisë dhe agropërpunimit; VKB nr.43 datë 29.06.2026 për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet të sip. 0.09 ha të pas.nr.546/4 ZK nr.3506 e llojit "pa fryt" fshati Stajkë, bashkia Vau-Dejës, për veprimtari blegtorie dhe agropërpunim".*

Për sa trajtuar, Prefekti iu autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Holta DUDA**

**ME URDHËR DELEGIMI**

**NËNPREFEKTI**

**BASHKIA VAU DEJËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr 42 Datë 28.06.2026

**"Për dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr 92, Zk nr 2644, e llojit "Shkëmbore" (*Pa fryt*), fshati Melgushë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës: "Për veprimtari në fushën e blegtorisë dhe agropërpunimit"**

Bazuar në nenin 8, pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*", ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, në VKM nr 246, dt 31.03.2011, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, dt 28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës", në VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar, Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, "*Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014*" (*sipërcituar*), çertifikatën e pronësisë nr 444822, lëshuar me datë 07.07.2011 nga ASHK Drejtoria Vendore Shkodër, si dhe të projekt vendimit nr 03, datë 15.06.2026, paraqitur nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve, pas shqyrtimit, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI :**

**1.**Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.43 ha, e llojit "Shkëmbore" (*Pa fryt*), pasuria nr 92, Zk nr 2644, fshati Melgushë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës:"Për veprimtari në fushën e blegtorisë".

**2.**Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve si dhe Administrata e Bashkisë.

**3.**Pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut, do vijohet me shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe procedurat e konkurimit publik me të gjithë elementët e saj përbërës, në përputhje me VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, "*Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014...........*" (sipërshkruar).

**4.**Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes Publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS -

**KRYETAR KËSHILLI**
**Ervis Shimaj**

**SEKRETAR KËSHILLI**
**Ardian Çelepija**

Miratuar me 17 vota
Vota Pro 17
Vota Kunder —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 02.07.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

**PROJEKT VENDIM**

Nr 03 Datë 15.06 2026

**"Miratimin në parim, dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr 92, Zk nr 2644, e llojit "Shkëmbore" (*Pa fryt*), fshati Melgushë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës.**
**Fusha e përdorimit të pronës: "Për veprimtari në fushën e blegtorisë".**

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743 datë 22.02.2001, "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*", ligji nr 8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, VKM nr 246, datë 31.03.2011, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr 68, datë 28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës*", në VKM-në nr 54, datë 05.02.2014, "*Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", ndryshuar, Udhëzimin nr 13, datë 26.04.2018, "*Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", si dhe në Çertifikatën e pronësisë nr 444822, lëshuar me datë 07.07.2011, propozojmë që në mbledhjen e radhës, Këshilli Bashkiak të:

**VENDOSI :**

1. "Miratimin në parim "Dhënie në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr 92, Zk nr 2644, sipas plan rilevimit bashkëlidhur, e llojit "Shkëmbore" (*Pa fryt*), ndodhur në fshatin Melgushë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës". Fusha e përdorimit të pronës: "Për veprimtari në fushën e blegtorisë".

2. Efektet: Sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike, ka impakt pozitiv duke mirëmbajtur pronën, duke e vënë në efiçencë dhe duke hapur vende të reja pune.

3. Tarifa e qirasë vjetore, afati i dhënies me qira dhe gjithë procedura në vazhdim me të gjithë elementet e saj përbërës, do jetë në përputhje me parashikimet e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, "*Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, për përcaktimin e kritereve, të*

*procedurëse të dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar.*

4. Pas miratimit të këtij projekt vendimi në Këshill Bashkiak dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut, do vazhdohet me shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe me procedurat e konkurimit publik konform legjislacionit në fuqi për dhënien në përdorim të pasurisë shtetërore, deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

**HARTOI PROJEKT VENDIMIN**

**DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE**

**Sp/Juriste Denada Dodaj** **P/sek. Ndoc Baqli** **Drejtori Marinela Deda**

**KRYETARI**
**Kristian Shkreli**

**ME VENDIM DELEGIMI**

**ZV/KRYETARI**
**Aleksandra Gjoni**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU I DEJES

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejes.Telefon/Faks 0035526120006,e-mail:info@vaudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE DHE ASETEVE

# RELACION

**Dhënie në përdorim të siperfaqes prej 0.43 ha, pasuria nr 92, Zk nr 2644, e llojit "Shkëmbore" (*Pa fryt*), ndodhur në fshatin Melgushë, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës; "Për veprimtari në fushën e blegtorisë".**

**Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i Aseteve në territorin e Bashkisë Vau u Dejës është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.
Bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore",neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el, neni18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë. nëpërmjet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në përdorim të pasurisë shtetërore.

Në projekt vendimin që po ju paraqesim bashkëlidhur, siperfaqja që propozohet të jepet në përdorim ështe me nr pasurie 92, Zk 2644, e llojit "Shkëmbore" (*Pa fryt*), me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.43 Ha, (4300 m2).
Kjo pasuri është e paisur me çertifikatë pronësie me nr 444822, datë 07.07.2011, në favor të Komuna Bushat (sot NJAD), e llojit "Shkëmbore", e cila duke qenë tokë cilësisht shumë e dobët, është e njejtë me tokat e llojit "Pa fryt".
Në fragmentin e hartes kadastrale lidhur me çertifikatën, ka emërtimin "P.F", "Pa fryt".

Ndodhur në këto kushte, për efekt të tarifimit të qirasë vjetore dhe procedurave të konkurimit publik, meqenëse në tabelën e zërave kadastral të pasurive që jepen me qira sipas përcaktimeve të VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", i ndryshuar, nuk parashikohet emërtimi "Shkëmbore", në përllogaritje dhe në çdo procedurë që do bëhet në vijim do të pasqyrohet krahas emërtimit "Shkëmbore", me emërtimin "Pa Fryt".

Bazuar në verifikimin në terren të gjendjes faktike për këtë pasuri, rezulton se prona është e paprekur nga ndërtime apo ndërhyrje të tjera. Toka është cilësisht shumë e varfër, dhe meqenëse ka qenë e pashfrytëzyeshme deri tani, ka ofruar mundësi për hedhje mbeturinash në mënyrë abuzive, për rrjedhojë, me qëllimin për ta vënë në efiçencë, duke sjellë të ardhura dhe duke mirëmbajtur pronën, një mënyrë e mirë mendojmë se është ti jepet në përdorim të tretëve me kontratë qiraje sipas legjislacionit në fuqi për dhënien në përdorim të pasurisë shtetërore, duke ndjekur të gjitha procedurat e konkurimit publik deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

Bazuar në pikën 34 të Udhëzimit nr 13, datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014 "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës..............*", (*sipërshkruar*), theksohet se tarifa dysheme për dhënie me qira të pasurisë shtetërore të llojit "Pa fryt", nuk mund të jetë më e ulët se 27 000 lekë/ha në vit.

Sa më sipër, propozojmë të miratoni në parim projekt vendimin e paraqitur.

Duke ju uruar punë të mbarë,

**Hartuesit e Relacionit**

| | | |
|---|---|---|
| **Denada Dodaj** | **Ndoc Baqli** | **Marinela Deda** |

**KRYETARI**
**Kristian Shkreli**

**ME VENDIM DELEGIMI**
**ZV/KRYETARI**
**Aleksandra Gjoni**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU I DEJËS

SEKRETARIA ... VAU DEJËS

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

444822

Zyra e Regjistrimit: SHKODER Zona Kadastrale Nr. 2644

Numri i Pasurisë: 92 Volumi 5 Faqe 240

Adresa e Pasurisë: MELGUSHE - SHKODER

Lloji i Pasurisë: SHKEMBORE

Sipërfaqja Totale: 4300 m² (KATERMIJE E TREQINDE) m²

Nga kjo : Sa Truall: - Nga kjo : Sa Ndërtesa: -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes: - %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| KOMUNA | | BUSHAT | I | MELGUSHE |
| | | | | SHKODER |

- është pronar i: PASURISE ME NR. 92
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart: -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi: -
- kufizimet e pasurisë janë : V 94/5, L 91/4, J 91/4, P 41/5

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 09.06.2011 Nr. 286**

Data e lëshimit të çertifikatës: 07.07.2011

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
( NERITAN KALAMISHI )

REPUBLIKA E SHQIPERISE ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME ZVRPP SHKODER

SEKRETARIA ... SHKAVAV DEJES

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

| ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME | A. IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| SHKODER | ZONA KADASTRALE 2644 NR. I PASURISE 92 VOL 5 FQ 240 |
| ING. G. TERNOVA | INDEKSI I HARTES K-34-76-(1-D) SHKALLA 1:2500 |
| [signature] | ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER d/F MELGUSHE |
| Z.V.R.P.P. SHKODER | Rr/L. ______ P/G ______ Sh ______ K ______ Ap ______ |
| Vula | **B. KUFIZIMET** V. 94/5, L. 91/4, J. 91/4, P. 415 — **C. PRONARI** KOMUNA BUSHAT, S=4300 m² |
| | D. Data: 28/6/2011, Ora: ______ |



# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

DATE 19.06.2026 QELLIMI:

PRONAR: Bashkia Vau Dejes

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| VENDNDODHJA<br>BASHKIA VAU DEJES | DVASHK/ZVASHK SHKODER | ZONA KADASTRALE 2644<br>FSHATI: MELGUSHE | NUMRI I PASURISE 92<br>VOL 5 FQ 240 | INDEX HARTE K-34-76-(1-D) |
| TE DHENAT E PASURISE<br>LLOJI I PASURISE: Pe Fruj | SIP. PASURISE= 4300 m² | SIPERFAQE E GJURMES NDERTIMIT= ______ m² | NUMRI I KATEVE __ | NUMRI I PEMEVE ____ |




| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI I KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | 94/5 | | |
| 2 | LINDJE | | | 91/4 | | |
| 3 | JUG | | | 91/4 | | |
| 4 | PERENDIM | | | 415 | | |

REALIZOI PER BASHKINE ______

EMRI: OLTA VELAJ

LICENCA: NR. T-1464 DATE 30.03.2021

KOMPANIA: ______

NIPT: ______

NENSHKRIMI/VULA: ______

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI: ______

DVASHK: ______

NENSHKRIMI: ______

Olta Velaj

Digitally signed by Olta Velaj
Date: 2026.06.19

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI ______

NENSHKRIMI/VULA ______

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, G, Z

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI I KUFIRIT: P, HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kuftaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARDHENIET ME KUFITARE

EMRI: Bashkia Vau Dejes

NENSHKRIMI: ______

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total, D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kuftaret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale;